

VENDIM
Nr. 89, datë 13.5.2024

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENSCO TRADING (ALBANIA)”
SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 586/18 prot., datë 10.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘ENSCO Trading (Albania)’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 27.3.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 6.9.2019.

- Me vendimin nr. 67, datë 12.4.2024, u vendos zgjatja e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me këtë aplikimin, për shkak të kohës së pamjaftueshme për zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë, si dhe shqyrtimin e dokumentacionit që shoqëria duhet të dorëzonte në ERE.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 586/12 prot., datë 16.4.2024, njoftoi shoqërinë mbi vendimmarrjen, si më sipër cituar, gjithashtu, me shkresën nr. 586/14 prot., datë 23.4.2024 dhe shkresën nr. 586/16 prot., datë 26.4.2024, ka vijuar korrespondencën mbi dokumentacionin e mbetur të paplotësuar.

- Shoqëria, me shkresën nr. 586/13 prot., datë 22.4.2024, shkresën nr. 586/15 prot., datë 24.4.2024 dhe shkresën nr. 586/17 prot., datë 26.4.2024, ka depozituar dokumentacion shtesë.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 7.9.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë

Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.
Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti